



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.99

22 shtator

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.598, datë 31.8.2006	Për një shtesë në vendimin nr.305, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv dhe mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që arrijnë këto nivele”.....	4003
Vendim i KM nr.601, datë 31.8.2006	Për disa shtesa në vendimin nr.523, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për njohjen dhe ekuivalentimin e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta, të huaja”.....	4003
Vendim i KM nr.609, datë 7.9.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.405, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet e nxjerrjes së pullës postare shqiptare”.....	4004
Vendim i KM nr.616, datë 7.9.2006	Për kalimin e disa mjediseve në përgjegjësi administrimi të Grupit Mbikëqyrës, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni.....	4004
Vendim i KM nr.617, datë 7.9.2006	Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore.....	4006
Vendim i KM nr.618, datë 7.9.2006	Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar.....	4014
Vendim i KM nr.619, datë 7.9.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfitimet nga statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar.....	4016

Udhëzim i KM
nr.5, datë 7.9.2006

Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit “K” për vitin 2006.....	4017
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shpëtim Gjyli.....	4021

VENDIM
Nr.598, datë 31.8.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.305, DATË 24.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELIT TË LARTË SPORTIV
DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE, QË ARRIJNË KËTO NIVELE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” dhe të neneve 124 e 125 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.305, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1.Kategoria e të rinjve, që arrijnë rezultatet e përcaktuara në pikën 1 të vendimit, shpërblehet në masën 25 për qind të vlerës së përcaktuar për të rriturit, sipas tarifave të tabelës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.601, datë 31.8.2006

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.523, DATË 1.8.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJOHJEN DHE EKUIVALENTIMIN E DIPLOMAVE DHE TË
CERTIFIKATAVE TË FITUARA NË SHKOLLAT E LARTA, TË HUAJA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 43 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.523, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4. Njohja akademike e diplomave dhe e certifikatave të fituara në shkollat e larta dhe akademitë ushtarake ose ato të policisë, të huaja, kryhet me po ato mënyra si në pikat 2, 3 e 4 të vendimit, dhe realizohet nga ministritë përkatëse, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme”.

2. Në pikën 5, pas fjalëve: “Ministria e Arsimit dhe Shkencës...” shtohen “...dhe Ministria e Mbrojtjes e Ministria e Brendshme...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.609, datë 7.9.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 27.7.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUSHTET E NXJERRJES SË PULLËS POSTARE SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.405, datë 27.7.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Pranë ministrisë, përgjegjëse për shërbimet postare, funksionon Komisioni Shtetëror i Pullës Postare Shqiptare, i cili ka në përbërje specialistë të shërbimeve postare, personalitete të njohura të shkencës, kulturës, artit, përfaqësues nga fusha e filatelistë, si dhe përfaqësues nga “Posta Shqiptare”, sha.

Anëtarët e këtij komisioni emërohen nga ministri.”.

b) Në pikën 3, emërtimi “... DPPT-në...” zëvendësohet me “... drejtorisë përgjegjëse për shërbimet postare ...”.

c) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Emetimi, vënia dhe heqja nga qarkullimi i çdo emisioni të pullave postare miratohen nga drejtoria përgjegjëse për shërbimet postare.”.

ç) Kudo në vendim emërtimi ““Albaposta”, sha” zëvendësohet me “Posta Shqiptare”, sha.”.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.616, datë 7.9.2006**

**PËR KALMIN E DISA MJEDISEVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË GRUPIT
MBIKËQYRËS, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KËTIJ INSTITUCIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Financave te Grupi Mbikëqyrës i kontrollit financiar, të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë, të disa mjediseve, përkatësisht 4 (katër) zyra, të ndërtesës 5-katëshe, të ish-Ndërmarrjes së Librit dhe Filmit në Tiranë.

2. Ngarkohen Ministri i Financave, përfaqësuesi i Grupit Mbikëqyrës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

Arëks 1



VENDIM
Nr.617, datë 7.9.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË VLERËSIMIT DHE TË MONITORIMIT TË
 PROGRAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI
 TË KUFIZUARA DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pika 4, e 31, shkronjat “g” e “gj”, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Monitorimi dhe vlerësimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe i shërbimeve shoqërore realizohen në nivel vendor e kombëtar dhe kanë për qëllim:

- monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave, të masave e veprimeve, në zbatim të legjislacionit, strategjive dhe programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, rezidenciale apo komunitare, të ofruara nga persona juridikë, publikë dhe privatë;

- vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve, në zbatim të politikave dhe programeve të mbrojtjes shoqërore;

- vlerësimin e ndikimit të politikave në uljen e varfërisë, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta;

- hartimin e rekomandimeve dhe të politikave për mbështetjen e grupeve në nevojë.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëpërmjet strukturave që ka në varësi, grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore, si dhe harton raporte në fushën e ndihmës e të shërbimeve shoqërore, për:

- përcaktimin e nevojave për shërbime për grupet në nevojë të popullsisë;

- përcaktimin e familjeve të varfëra dhe të individëve, që kanë nevojë të mbështeten me pagesë në “cash” apo me shërbime shoqërore;

- përcaktimin e numrit dhe të shërbimeve shoqërore, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në nivel qarku, në bashki dhe komuna;

- vlerësimin e nevojave për shërbime të reja, në përputhje me kërkesat dhe burimet për ngritjen e tyre.

3. Bashkitë/komunat, çdo dy muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, hartojnë dhe dërgojnë në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për gjendjen e familjeve, që përfitojnë ndihmë ekonomike, për numrin e familjeve përfituese, numrin e personave me aftësi të kufizuara, që mbështeten me pagesë, si dhe për fondet e përdorura, sipas modularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Bashkitë/komunat, çdo katër muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, hartojnë dhe dërgojnë në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të dhëna statistikore për numrin dhe llojet e shërbimeve, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe për nevojat për shërbime të reja të përkujdesjes shoqërore, sipas modularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Personat juridikë, publikë dhe privatë, dhe organizatat jofitimprurëse të licencuara sipas vendimit nr.564, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, në përfundim të çdo 4-mujori, brenda datës 10 të muajit pasardhës, të dërgojnë në bashkinë/komunën, ku ofrojnë shërbimet, si dhe në drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të dhëna statistikore për shërbimet e ofruara, sipas modularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, çdo katër muaj, vlerëson, përpunon dhe standardizon të dhënat e grumbulluara nga bashkitë/komunat, sipas pikave 3, 4 e 5 të këtij vendimi, dhe ia dërgon, sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

7. Bashkitë/komunat, personat juridikë, publikë dhe privatë, e organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime shoqërore, i dërgojnë një kopje të raportit të të dhënave, çdo katër muaj, sektorit të shërbimeve shoqërore në qark, në përputhje me vendimin nr.563, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përgjegjësisë së qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.

8. Drejtoria rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet aktmarrëveshjeve të veçanta, vendos marrëdhënie bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave statistikore, periodike, me zyrat e

punësimit, zyrën e statistikës, zyrat e sigurimeve shoqërore, drejtoritë arsimore dhe ato shëndetësore në rrethe, sektorin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark (SAMT), zyrën e regjistrimit të pronave dhe të automjeteve, si dhe me institucione të tjera, që veprojnë në nivel qarku.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara në përputhje me standardet e përcaktuara me udhëzim të ministrit, i dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila i përpunon ato për realizimin e qëllimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

10. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin për mënyrën e paraqitjes së të dhënave statistikore, nga strukturat përgjegjëse, sipas këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Modular 1

Nr.	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përmbajtja	Specifikime	Periodiciteti
1	Familjet e varfëra	Numri i familjeve gjithsej	Tregon numrin e familjeve gjithsej të bashkisë/komunës sipas regjistrimit	-sipas regjistrimit të gjendjes civile -sipas Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (2001)	Çdo dy muaj
2		Numri i familjeve në NE	Tregon numrin e familjeve në bashki/komunë që përfitojnë NE për periudhën	Sipas llojit të NE (e plotë ose e pjesshme) Sipas numrit të anëtarëve Sipas kohëzgjatjes në skemë Sipas gjinisë së kryefamiljarit	Çdo dy muaj
3		Numri i familjeve në NE me fëmijë 0-15 vjeç	Tregon numrin e familjeve në bashki/komunë që përfitojnë NE për periudhën dhe që kanë në përbërje fëmijë të gurmshës 0-15 vjeç	Sipas grupmoshave (parashkollë, shkollë fillore dhe/ose 9-vjeçare) Sipas gjinisë Sipas pjesëmarrjes në shkollë ose jo	Çdo dymuaj
4		Numri i familjeve në NE që kanë në përbërje PAK	Tregon numrin e familjeve në bashki/komunë që përfitojnë NE për periudhën dhe që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara	Sipas llojit të paaftësisë Sipas grupmoshave Sipas gjinisë	Çdo dy muaj
5		Numri i familjeve që hyjnë në skemën e NE	Tregon numrin e familjeve në bashki/komunë që futen në skemën e NE për periudhën	Sipas shkakut të futjes në skemë	Çdo dy muaj
6		Numri i familjeve që dalin nga skema e NE	Tregon numrin e familjeve në bashki/komunë që dalin nga skema e NE për periudhën	Sipas shkakut të daljes nga skema	Çdo dy muaj
7		Numri i familjeve që trajtohen nga pushteti vendor me përfitime të veçanta	Tregon numrin e familjeve në bashki/komunë, që mbi bazën e kriterëve specifike mbështeten me fondet e pushtetit vendor me ndihmë ekonomike ose forma të tjera ndihme	Sipas numrit të anëtarëve Sipas grupmoshës së fëmijëve apo PAK në përbërje të familjes Sipas gjinisë së kryefamiljarit	Çdo dy muaj

8		Masa mesatare mujore e NE për familje	Tregon vlerën mesatare mujore në lekë që merr familja në NE në	Sipas llojit të NE (e plotë, e pjesshme)	Çdo dy muaj
---	--	---------------------------------------	--	--	-------------

			bashki/komunë për periudhën		
9		Shuma e përfitimeve të NE	Tregon shumën e fondit nga buxheti qendror të shpenzuar për NE në bashki/komunë për periudhën (në 000/lekë)	Sipas llojit të NE 9 (e plotë, e pjesshme)	Çdo dy muaj
	Personat me aftësi të kufizuara (PAK)	Numri i PAK	Tregon numrin e PAK në bashki/komunë që përfitojnë pagesë paaftësie për periudhën	Sipas llojit të paaftësisë Sipas masës së përfitimit të pagesës Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo dy muaj
		Numri i personave me përfitim kujdestarie	Tregon numrin e personave në bashki/komunë që përfitojnë pagesë kujdestarie për periudhën	Sipas llojit të paaftësisë Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo dy muaj
		Numri i invalidëve të punës	Tregon numrin e invalidëve të punës në bashki/komunë që përfitojnë pagesë për aftësi të kufizuar për periudhën	Sipas shkallës së invaliditetit (e plotë e pjesshme) Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo dy muaj
		Pagesa mesatare mujore për një person të paaftë	Tregon vlerën mesatare mujore në lekë që merr një PAK	Sipas llojit të paaftësisë	Çdo dy muaj
		Shuma e përfitimeve të pagesës së paaftësisë	Tregon shumën e fondit të shpenzuar për pagesë paaftësie në bashki/komunë për periudhën (në 000/lekë)	Sipas llojit të paaftësisë Sipas masës së përfitimit të pagesës	Çdo dy muaj
		Shuma e përfitimeve të pagesës për invalidët e punës	Tregon totalin e fondit të shpenzuar për pagesën e invalidëve të punës në bashki/komunë për periudhën (në 000/lekë)	Sipas shkallës së invaliditetit (e plotë, e pjesshme)	Çdo dy muaj
		Numri i PAK në familjet e varfëra	Tregon numrin e PAK në bashki/komunë që jetojnë në familjet që përfitojnë NE për periudhën	Sipas llojit të paaftësisë Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo dy muaj
		Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar	Tregon numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (0-18 vjeç) në bashki/komunë për periudhën	Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas sistemit arsimor që ndjekin	Çdo dy muaj

Modular 2

Nr.	Grupi i synuar	Indikator i monitorueshëm	Përmbajtja	Specifikime	Periodiciteti
	Fëmijë në nevojë	Numri i qendrave publike të	Tregon numrin e qendrave publike	Sipas llojit të qendrës	Çdo 4-mujor

		përkujdesit shoqëror	rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas statusit të klientëve	
		Numri i klientëve të vendosur në qendrat publike	Tregon numrin e klientëve përfitues të shërbimeve sociale në qendrat publike në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas gjendjes së aftësisë Sipas statusit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie ose komune për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror në qendrat publike për periudhën	Sipas llojit të shërbimit që kërkohet Sipas grupmoshës së kërkuesit Sipas gjinisë së kërkuesit	Çdo 4-mujor
		Fondi i shpenzimeve në qendrat publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat publike të përkujdesit shoqëror në qark/bashki për periudhën (000/lekë)	Sipas llojit të qendrës Sipas statusit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i qendrave jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të shërbimeve që ofrojnë për klientë të ndryshëm	Çdo 4 mujor
		Numri i klientëve përfitues të shërbimeve në qendrat jopublike	Tregon numrin e klientëve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki në qendrat jopublike për periudhën	Sipas gjendjes së klientit Sipas grupmoshave Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të klientëve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki/komunë për periudhën	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit, Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
	Gra në nevojë	Numri i qendrave publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas llojit të qendrës Sipas statusit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Fondi i shpenzimeve në qendrat publike të	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat publike të përkujdesit	Sipas llojit të qendrës Sipas statusit të klientëve	Çdo 4-mujor

		përkujdesit shoqëror	shoqëror në qark/bashki për periudhën (000/lekë)		
		Numri i qendrave jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve përfitues të shërbimeve të përkujdesit	Tregon numrin e klientëve që përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror (publike apo jopublike) në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të qendrës Sipas llojit të shërbimit Sipas grupmoshës Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj.	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të klientëve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki/komunë për periudhën	Sipas gjendjes familjare shoqërore, shëndetësore, arsimimit Sipas grupmoshës	Çdo 4-mujor
	Të rinj në nevojë	Numri i qendrave publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime e përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas llojit të qendrës Sipas statusit të klientëve	Çdo 4 mujor
		Fondi i shpenzimeve në qendrat publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat publike të përkujdesit shoqëror në qark/bashki për periudhën (000/lekë)	Sipas llojit të qendrës Sipas statutit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i qendrave jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e OJF-ve që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve përfitues të shërbimeve të përkujdesit	Tregon numrin e klientëve që përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror (publike apo OJF) në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të qendrës Sipas grupmoshës Sipas statusit familjar, shoqëror, shëndetësor etj. Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të klientëve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki/komunë për periudhën	Sipas gjendjes familjare, shoqërore, shëndetësore, arsimimit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor

	Të moshuar në nevojë	Numri i qendrave publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas numër të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve të vendosur në qendrat publike	Tregon numrin e klientëve përfitues të shërbimeve sociale në qendrat publike në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas grupmoshës Sipas gjinisë Sipas statusit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie ose komune për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror në qendrat publike për periudhën	Sipas statusit të kërkuesit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
		Fondi i shpenzimeve në qendrat publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat publike të përkujdesit shoqëror në qark/bashki për periudhën (000/lekë)	Sipas numrit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i qendrave jopublike që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 4-muaj
		Numri i klientëve përfitues të shërbimeve nga qendrat jopublike	Tregon numrin e klientëve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga qendrat jopublike për periudhën	Sipas gjendjes së klientit Sipas grupmoshave Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të klientëve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki/komunë për periudhën	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore, Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
	Persona me aftësi të kufizuara	Numri i qendrave publike të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave publike rezidenciale ose ditore që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror për grupin e synuar në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas llojit të shërbimit	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve të	Tregon numrin e klientëve përfitues	Sipas llojit të paaftësisë	Çdo 4-mujor

		vendosur në qendrat publike	të shërbimeve sociale në qendrat publike në nivel qarku dhe bashkie për periudhën	Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	
		Numri i kërkesave për përfitim të shërbimeve shoqërore në qendrat publike	Tregon numrin e kërkesave të bëra pranë strukturave përkatëse në nivel qarku, bashkie ose komune për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror në qendrat publike për periudhën	Sipas statusit të kërkuesit Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
		Fondi i shpenzimeve në qendrat publike të përkujdesit shoqëror	Tregon totalin e fondit të shpenzuar në qendrat publike të përkujdesit shoqëror një qark/bashki për periudhën (000/lekë)	Sipas numrit të klientëve	Çdo 4-mujor
		Numri i qendrave jopublike që ofrojnë shërbim të përkujdesit shoqëror	Tregon numrin e qendrave jopublike që ofrojnë shërbime për grupin e synuar në qark/bashki për periudhën	Sipas llojit të shërbimit që ofrojnë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve përfitues të shërbimeve nga qendrat jopublike	Tregon numrin e klientëve që përfitojnë shërbime shoqërore në qark/bashki nga qendrat jopublike për periudhën	Sipas llojit të paaftësisë Sipas grupmoshave Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor
		Numri i klientëve në nevojë	Tregon numrin e identifikuar nga strukturat përkatëse (shtetërore apo OJF) të klientëve që kanë nevojë për shërbime shoqërore në bashki/komunë për periudhën	Sipas gjendjes familjare, shëndetësore Sipas grupmoshës Sipas gjinisë	Çdo 4-mujor

VENDIM
Nr.618, datë 7.9.2006

**PER PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË
PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 11, pika 1, e 20, pika 3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, të Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteret dhe grupet, që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar

1. Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikiko/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.

2. Personat, paraplegjikë e tetraplegjikë, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkakut dhe mosha, përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.

3. Personat me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, të cilët, me vendim të komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.

4. Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet nga KMCAP-i, i cili është i ngritur dhe funksionon pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe mjeku, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.

5. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve të KMCAP-it përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përveç pagesës së mjekut, i cili është punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.

6. Invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Shërbimit Social Shtetëror.

7. Kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

II. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar

8. Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, është 6 800 (gjashtë mijë e tetëqind) lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi.

9. Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të cilët ndjekin arsimin e mesëm, me ose pa shkëputje nga puna, apo kurse kualifikimi, përfitojnë 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj.

10. Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të cilët ndjekin arsimin e lartë apo studimet pasuniversitare me ose pa shkëputje nga puna, si dhe kanë mbrojtur gradë shkencore, përfitojnë 21 000 (njëzet e një mijë) lekë në muaj.

Pagesa për gradë shkencore është e përhershme dhe bëhet mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente.

Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të cilët ndjekin, njëkohësisht, arsimin e mesëm apo të lartë dhe një kurs kualifikimi, përfitojnë vetëm njërën nga pagesat.

11. Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, të cilët ndjekin shkollën e mesme, të lartë, me dhe pa shkëputje nga puna, apo studime pasuniversitare, paguhen

vetëm gjatë periudhës së ciklit shkollor.

12. Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2, e përfitojnë pagesën shtesë edhe në rastet kur studimet zgjasin edhe një vit më shumë sesa kohëzgjatja normale e ciklit shkollor.

13. Pagesa e kujdestarit të personit me aftësi të kufizuara, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, është në masën 6 800 (gjashtë mijë e tetëqind) lekë në muaj.

14. Familjet, që kanë në përbërje dy a më shumë persona me aftësi të kufizuara, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të cilët, me vendim të komisionit mjekësor, kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë pagesë për kujdestarin, në masën 150 për qind të masës së përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.

15. Masat e përfitimeve, të përcaktuara në pikat 9, 10, 13 dhe 14 të këtij vendimi, ndryshojnë në të njëjtën përqindje me të cilën rritet masa e përfitimit të përcaktuar në pikën 8 të këtij vendimi.

16. Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike, si dhe në të ardhurat personale të personave, që vendosen në institucionet publike të përkujdesit shoqëror.

17. Pagesa për personat, që përfitojnë nga ky vendim, si dhe e kujdestarit bëhet një herë në muaj.

18. Personave me aftësi të kufizuara, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të cilët komisionohen për herë të parë në KMCAP, u lind e drejta e përfitimit të pagesës dy muaj pas marrjes së vendimit nga ky komision.

III. Procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e pagesës për aftësi të kufizuar

19. Personat, që kërkojnë të komisionohen për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, duhet të paraqesin në seksionet e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore të bashkisë/komunës, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Certifikatën e gjendjes familjare;

b) Certifikatën personale me fotografi;

c) Vendimin e mëparshëm të KMCAP-it, i cili vërteton shkallën e aftësisë së kufizuar të personit;

ç) Fletëdrejtimin për në KMCAP, kur personi komisionohet për herë të parë;

d) Epikrizën përcjellëse, sa herë rikomisionohet.

20. Kur personi me aftësi të kufizuara, i cili, me vendim të komisionit mjekësor, përcaktohet se ka nevojë për përkujdesje, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 19, duhet të paraqesë edhe këto dokumente shtesë:

a) Certifikatën personale, me fotografi, të personit kujdestar;

b) Deklaratën/vendimin gjyqësor, për kujdestarin e zgjedhur nga personi me aftësi të kufizuara;

c) Raportin mjeko-ligjor, që vërteton se kujdestari është i aftë, fizikisht dhe mendërisht.

21. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin shkollën e mesme apo shkollën e lartë, me apo pa shkëputje nga puna, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 19, duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i shkollës, ku të shënohen:

i) Emri i personit që ndjek shkollën;

ii) Lloji i arsimit që ndjek, ku përcaktohet, nëse është cikël shkollor, normal ose i përsëritur;

iii) Vitin shkollor.

b) Vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i shkollës për frekuentimin e shkollës nga personi përfitues (çdo tre muaj).

c) Kopjen e noterizuar të dëftesës shkollore të çdo viti dhe kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme apo të lartë, si dhe kopje të dëshmive të kurseve kualifikimit.

ç) Vërtetimin se ka shlyer detyrimet për çdo sezon, për shkollën e lartë, pa shkëputje nga puna.

22. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët vazhdojnë studimet pasuniversitare, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 19, duhet të paraqesin edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Vërtetimin nga institucioni ku vazhdon studimet pasuniversitare, në të cilin të jenë përcaktuar emri i personit, lloji i studimit dhe kohëzgjatja.

b) Vërtetimin nga titullari i institucionit, për frekuentimin e studimeve. Kur studimet zgjasin më shumë se 6 muaj, vërtetimi duhet të paraqitet një herë në tre muaj.

c) Kopjen e noterizuar të diplomës apo të dëshmisë së përfundimit të studimeve pasuniversitare ose të mbrojtjes së gradës shkencore.

23. Personat me aftësi të kufizuara, ditën e komisionimit, i dorëzojnë KMCAP-it certifikatën në fotografi dhe epikrizën përcjellëse ose fletëdrejtimin për në këto komisione.

24. Administratori shoqëror i bashkisë/komunës, çdo muaj, dërgon, me procesverbal, pranë mjekut të drejtorisë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, listën e personave, që do të paraqiten a riparaqiten pranë KMCAP-it, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe njofton personat për datën e paraqitjes pranë këtyre komisioneve. Mjeku verifikon nëse dosjet e paraqitura janë të plotësuar me dokumentacionin përkatës dhe, më pas, i përcjell ato në KMCAP.

25. Drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, në përfundim të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, për personat aplikues, nga KMCAP-i dërgojnë në drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror listat e personave të deklaruar me aftësi të kufizuara, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, si dhe një kopje të vendimit të KMCAP-it për çdo person. Mjeku rajonal i Shërbimit Social Shtetëror harton regjistrin e personave me aftësi të kufizuara, sipas pikave 1 e 2 të vendimit, të vlerësuar nga KMCAP-i dhe dërgon, në çdo bashki/komunë, listën e personave dhe vendimin e KMCAP-it për secilin person.

IV. Dispozita të përgjithshme

26. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

27. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzime, në zbatim të këtij vendimi.

28. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zbatimin e këtij vendimi.

29. Vendimi nr.786, datë 26.11.2003 i Këshillit të Ministrave “Për komisionimin dhe pagesën e personave me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM Nr.619, datë 7.9.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000.”.

b) Paragrafi i parë i pikës 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e pagesës për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që janë bërë të tillë për shkaqe që lidhen me punësimin, është 6 800 (gjashtë mijë e tetëqind) lekë në muaj dhe indeksohet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që ata përfitojnë nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për pagesën e paaftësisë, për vitin 2006, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komuna) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.5, datë 7.9.2006

PËR MIRATIMIN E KOSTOS MESATARE TË NDËRTIMIT TË BANESAVE, NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE, DHE TË KOEFICIENTIT “K” PËR VITIN 2006

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 nenit 14 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave, të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Kostoja mesatare e ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë republike, për vitin 2006, të jetë 29 220 (njëzet e nëntë mijë e dyqind e njëzet) lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi.

2. Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave, sipas qyteteve, për vitin 2006, të jetë sipas tabelave nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij udhëzimi.

3. Vlera e koeficientit “K” të jetë sipas tabelës nr.3, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatim të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KOSTO MESATARE E NDËRTIMIT PËR VITIN 2006

Tabela nr.1

Nr	Qyteti	Çmimi për njësi (mesatare arih.)	
		Sip.shfrytëzimi	Sip.ndërtimi
		Lek/m ²	Lek/m ²
1	Bajram Curri	31.877	27.904
2	Berat	28.732	25.150
3	Burrel	29.769	26.058
4	Durrës	30.823	26.976
5	Elbasan	27.548	24.113

6	Erskeë	28.590	25.025
7	Fier	28.948	25.340
8	Gramsh	28.244	24.723
9	Gjirokastër	30.009	26.267
10	Korçë	28.742	25.158
11	Krujë	28.376	24.838
12	Kavajë	28.484	24.934
13	Kuçovë	28.427	24.883
14	Kukës	31.262	27.366
15	Laç	28.353	24.818
16	Lezhë	30.252	26.477
17	Librazdh	28.227	24.708
18	Lushnje	29.299	25.647
19	Prrenjas	28.913	25.309
20	Peqin	28.421	24.878
21	Peshkopi	29.493	25.816
22	Përmet	28.745	25.161
23	Pogradec	28.303	24.772
24	Pukë	29.493	25.816
25	Rrëshen	28.462	24.913
26	Çorovodë	29.209	25.568
27	Sarandë	29.579	25.892
28	Shkodër	29.655	25.957
29	Tepelenë	28.796	25.206
30	Tiranë	28.860	25.262
31	Vlorë	31.174	27.283
Kosto mesatare		29.220	25.577

TË DHËNAT NË TREGUN E LIRË TË APARTAMENTEVE

Tabela nr.2

Nr	Qyteti	Kosto e shitjes lek/m2 sip.shfrytëz.për tregun e lirë
1	2	3
1	Bajram Curri	23 049
2	Ballsh	32 076
3	Berat	30 111
4	Bulqizë	15 814
5	Burrel	26 426
6	Cërrik	32 623
7	Corovodë	10 018
8	Delvinë	25 019
9	Devoll	35 876
10	Durrës	57 829

11	Elbasan	41 838
12	Ersekë	22 594
13	Fier	48 248
14	Fushë-Krujë	30 970
15	Fushë-Arrëz	6 777
16	Gjirokastrë	39 034
17	Gramsh	30 723
18	Himarë	50 279
19	Kavajë	48 738
20	Këlcyrë	16 862
21	Korçë	46 170
22	Koplik	36 775
23	Krujë	32 324
24	Krumë	30 276
25	Kuçovë	23 134
26	Kukës	27 851
27	Laç	28 296
28	Leskovik	21 230
29	Lezhë	66 798
30	Librazhd	36 033
31	Lushnje	40 190
32	Maliq	29 617
33	Memaliaj	10 899
34	Mamurras	19 463
35	Patos	31 307
36	Përmet	22 551
37	Peqin	34 979
38	Peshkopi	25 399
39	Pogradec	45 533
40	Poliçan	10 474
41	Prrenjas	34 350
42	Pukë	12 973
43	Roskovec	39 740
44	Rrëshen	31 078
45	Rubik	33 306
46	Sarandë	50 995
47	Shëngjin	66 798
48	Shkodër	45 763
49	Shijak	35 166
50	Tepelenë	18 360
51	Tiranë	79 615
52	Vau i Dejës	23 415
53	Vlorë	48 156
54	Vorë	46 725

VLEFTA E KOEFICIENTIT “K”

Tabela nr.3

Nr	Qyteti	Koeficienti korrigjues “K”
1	2	3
1	Bajram Curri	0 .7231
2	Ballsh	1.000
3	Berat	1.000
4	Bulqizë	0.5362
5	Burrel	0.8877
6	Cërrik	1.000
7	Corovodë	0.3430
8	Delvinë	0.8458
9	Devoll	1.000
10	Durrës	1.000
11	Elbasan	1.000
12	Ersekë	0.7903
13	Fier	1.000
14	Fushë-Krujë	1.000
15	Fushë-Arrëz	0.2298

16	Gjirokastrë	1.000
17	Gramsh	1.000
18	Himarë	1.000
19	Kavajë	1.000
20	Këlcyrë	0.5866
21	Korçë	1.000
22	Koplik	1.000
23	Krujë	1.000
24	Krumë	0.9685
25	Kuçovë	0.8138
26	Kukës	0.8909
27	Laç	0.9980
28	Leskovik	0.7366
29	Lezhë	1.000
30	Librazhd	1.000
31	Lushnje	1.000
32	Maliq	1.000
33	Memaliaj	0.3785
34	Mamurras	0.6865
35	Patos	1.000
36	Përmet	0.7845
37	Peqin	1.000
38	Peshkopi	0.8612
39	Pogradec	1.000
40	Polican	0.3724
41	Prrenjas	1.000
42	Pukë	0.4399
43	Roskovec	1.000
44	Rrëshen	1.000
45	Rubik	1.000
46	Sarandë	1.000
47	Shëngjin	1.000
48	Shkodër	1.000
49	Shijak	1.000
50	Tepelenë	0.6376
51	Tiranë	1.000
52	Vau i Dejës	0.7896
53	Vlorë	1.000
54	Vorë	1.000

KËRKESE

Shtetësja Hatixhe Gjyli, banuese në Durrës, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetasit Shpëtim Gjyli, i datëlindjes 25.2.1956.

Kërkuese
Hatixhe Gjyli

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-eksponatës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
2. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(Vëllimi II).....	500
3. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
4. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDERTIMET.....	500
8. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 20.9.2006
Doli nga shtypi më 22.9.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë